Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 24 qershor 2015

Lënda nr.233/09

PetarJOVIÇIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 24 qershor 2015,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 14 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009.

2. Më 12 maj 2010, Paneli kërkoi nga ankuesi të ofrojë informata shtesë. Përgjigja e ankuesit është pranuar më 14 tetor 2010.

3. Më 10 nëntor 2010,Paneli kërkoi nga ankuesi të ofrojë informata shtesë. Përgjigja e ankuesit ndaj kësaj kërkese është pranuar më 25 nëntor 2010.

4. Më 10 nëntor 2011,për ankesën u njoftua Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1], lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës.

5. Më 14 dhjetor 2011,PSSP-ja dha përgjigjen e tij.

6. Më 17 mars 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

7. Më 2 prill 2012, Paneli ia përcolli vendimin e vet PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës dhe gjithashtu kopjet e dokumenteve relevante për rastin.

8. Duke iu përgjigjur kërkesës së Panelit, më 29 qershor 2012 PSSP-ja ofroi komente shtesë mbi pranueshmërinë e ankesës dhe gjithashtu kopjet e dokumenteve relevante, i mbështetur nga UNMIK-u.

9. Më 11 qershor 2013, Paneli i kërkoi UNMIK-ut të konfirmojë nëse hapja e dosjeve që kanë të bëjnë me rastin mund të konsiderohet përfundimtare.

10. Më 18 qershor 2013, UNMIK-u ia konfirmoi Panelit se janë hapur të gjitha dosjet relevante në dispozicion.

11. Më 17 prill 2015, Paneli kërkoi nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX-i) të ofrojë informata shtesë.

12. Më 20 prill 2015, DML dha përgjigjen e vet.

13. Më 27 prill 2015, Paneli i kërkoi DML-së sqarim shtesë.

14. Më28prill 2015, DML dha përgjigjen e vet.

15. Më 14 maj 2015, Paneli kërkoi sqarim shtesë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK).

16. Më 18 maj 2015, KNKK-ja u përgjigj.

17. Po të njëjtën ditë, Paneli kërkoi sqarim shtesë nga KNKK-ja. KNKK-ja nuk dha përgjigje ndaj kësaj kërkese.

II. FAKTET

[1]Një listë me shkurtesa dhe akronime që përmban teksti mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

A. Historiku i përgjithshëm[2]

18. Ngjarjet në fjalë ndodhën në territorin e Kosovës pas krijimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut), në qershor të vitit 1999.

19. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së). Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ-ja u pajtua t'i tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ-ja dhe Republika e Serbisë nënshkruan një "Marrëveshje Tekniko-Ushtarake" përmes së cilës u pajtuan mbi tërheqjen e RFJ-së nga Kosova dhe praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë, pas miratimit të rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

20. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive. KFOR-i u ngarkua për krijimin e "një ambienti të sigurt, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt" dhe përkohësisht të sigurojë "rendin dhe sigurinë publike", derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë apo shtylla kryesore të udhëhequra nga OKB-ja (administrata civile), Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihma humanitare, e cila u hoq në qershorin e vitit 2000), OSBE-ja (ndërtimi institucional) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik). Secila shtyllë u vendos nën autoritetin e PSSP-së. Përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), UNMIK-ut i jepet mandati që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

21. Vlerësimet lidhur me ndikimin e konfliktit në shpërnguljen e popullatës shqiptare të Kosovës sillen prej përafërsisht 800,000 deri 1.45 milion. Pas miratimit të Rezolutës 1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin larguar, apo ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit, u kthyen në Kosovë.

22. Në ndërkohë, pjesëtarët e komunitetit joshqiptar-kryesisht serbët, dhe jo vetëm ata, por edhe romët dhe myslimanët sllavë si dhe shqiptarët e Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, u bënë shënjestër e sulmeve shumë të përhapura të grupeve të armatosura të

---

[2]Referencat e nxjerra nga Paneli për të përcaktuar historikun e përgjithshëm përfshijnë: OSBE, "Siç është parë dhe treguar", vëll. 1 (tetor 1998 – qershor 1999) dhe vëll. II (14 qershor – 31 tetor 1999); raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; Raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut (2000, 2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, "Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë" (2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, "Libër kujtimi për Kosovën" (htpp://www.kosovomemorybook.org); Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, Raport i Aktivitetit 2002-2004; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Behrami dhe Behrami kundër Francës* dhe *Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*, me numrat 71412/01 dhe 78166/01, vendimi i datës 2 maj 2007; Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, "Situata në Kosovë: Një vlerësim" (2010); të dhënat e publikuara nga Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, (në dispozicion në www.unhchr.org) dhe nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (në dispozicion në http://familylinks.icrc.org/kosovo/en).

shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet e tanishme lidhur me numrin e serbëve të Kosovës të zhvendosur sillen përafërsisht prej 200,000 deri 210,000. Ndërsa shumica e serbëve të Kosovës dhe joshqiptarët e tjerë të Kosovës u larguan në Serbi dhe në vendet fqinje, ata që mbetën prapa u bënë viktima të vrasjeve sistematike, rrëmbimeve, mbajtjeve arbitrare, dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, rrahjeve dhe frikësimit.

23. Megjithëse shifrat mbesin kontestuese, vlerësohet që më shumë se 15,000 vdekje apo zhdukje ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij (1998-2000). Më shumë se 3,000 shqiptarë etnikë dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera minoritare u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Për më shumë se gjysmën e personave të zhdukur janë gjetur dhe identifikuar mbetjet e tyre mortore deri në fund të vitit 2010, ndërsa 1,766 gjenden ende si të zhdukur në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), sipas të dhënave të muajit maj të vitit 2015.

24. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit që UNMIK-u tashmë e konsideronte çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht të madh për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në muajin nëntor të vitit 1999, u krijua Njësiti për Personat e Zhdukur (NJPZH) brenda Policisë së UNMIK-ut, me mandat të hetojë vendndodhjen e mundshme të personave të zhdukur dhe/apo varrezave. NJPZH-ja, së bashku me Njësitin Qendror për Hetim Penal (NJQHP) të Policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë Njësiti për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL), ishin përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Në maj të vitit 2000, u krijua Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave (KGJIV), i udhëhequr nga UNMIK-u, për të gjetur, identifikuar dhe dorëzuar mbetjet mortore. Më 5 nëntor 2001, UNMIK-u nënshkroi dokumentin e përbashkët UNMIK-RFJ duke ritheksuar, mes tjerash, përkushtimin e tij për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur nga të gjitha komunitetet, dhe duke pranuar se programi për zhvarrim dhe identifikim është vetëm një pjesë e aktiviteteve të lidhura me personat e zhdukur.Prej qershorit të vitit 2002, Zyra e sapoformuar për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut (DD), u bë autoriteti i vetëm i mandatuar për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, t'i identifikojë mbetjet e tyre mortore dhe t'ua kthejë ato familjes së të zhdukurit. Duke filluar nga viti 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet UNMIK-ut dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur me seli në Sarajevë (KNPZH), i plotësuar nga një marrëveshje tjetër në vitin 2003, identifikimi i mbetjeve mortore u krye nga KNPZH-ja përmes testit të ADN-së.

25. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.Megjithatë, UNMIK-u ruajti ca përgjegjësi në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale.

B. Rrethanat që ndërlidhen me zhdukjen e pretenduar të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq

26. Ankuesi është burri i znj. Krasenka Alinoviq.

27. Ai deklaron se më 15 qershor 1999,ai u largua nga Prizreni për shkaqe sigurie,por gruaja e tij mbeti në Spitalin e Prizrenit, ku ajo ishte pranuar më herët. Ai u vendos në një qendër për persona të zhvendosur në Fushë-Kosovë, gjatë së cilës kohë ai kërkoi nga autoritetet e

ndryshme, duke përfshirë UNMIK-un dhe KFOR-in, ta çojnë atë atje, por kërkesat e tij nuk u plotësuan. Më 14 gusht 1999 ai mësoi nga një pjesëtar i stafit të KNKK-së se gruaja e tij kishte vdekur në spital më 8 gusht 1999. Atij, po ashtu, i ishte thënë se ajo ishte varrosur nga komuna, në pjesën e varrezave të qytetit të Prizrenit, ku ishin varrosur serbët lokalë të cilët ishin vrarë.Pjesëtari i njëjtë i stafit të KNKK-së i ofroi ankuesit një kopje të certifikatës së vdekjes dhe një fotografi të varrit të znj.KrasenkaAlinoviq.Ankuesi thotë se ai nuk ka pranuar kurrë certifikatën origjinale të vdekjes apo dokumentet dhe gjësendet personale të gruas së tij, duke përfshirë stolitë e saj të çmuara.

28. Ankuesi ia paraqet Panelit një kopje të një certifikate të KNKK-së, e datës 18 tetor 1999, dërguar vajzës së znj.KrasenkaAlinoviq në Kroaci, në të cilën konfirmohet se znj. Alinoviq kishte vdekur në Spitalin e Prizrenit më 8 gusht 1999. Ai, po ashtu, e bashkëngjit një kopje të një certifikate të vdekjes, pa datë, nga spitali i Prizrenit, që konfirmon vdekjen e znj. Alinoviq më 8 gusht 1999. Po ashtu, ankuesi e bashkëngjit një raport nga Spitali i Prizrenit, i cili konfirmon se ajo ishte trajtuar në spital nga 20 marsi i vitit 1999deri në vdekjen e saj më 8 gusht 1999, në orën 15:15, dhe paraqitet shkaku i vdekjes së saj.

29. Ankuesi, po ashtu, thotë se ai kuptoi më vonë se të gjitha mbetjet mortore të varrosura në pjesën serbe të varrezave të Prizrenit ishin zhvarrosur, duke përfshirë ato të gruas së tij, dhe me sa duket ishin transportuar për në morgun e Rahovecit. Ai vazhdon duke thënë se, ai e kontaktoi z. S.D., një mjek i mjekësisë ligjore që punonte për Qeverinë serbe dhe e konsultoi atë rreth çështjes. Z. S.D.,me sa duket i tha atij se ai ishte i pranishëm në varrezë kur të gjitha mbetjet mortore nga atje ishin zhvarrosur.Ai premtoi t'i rishikojë shënimet dhe regjistrimet e tij në video, për të përcaktuar nëse mbetjet mortore të znj. Krasenka Alinoviq po ashtu ishin zhvarrosur. Disa ditë më vonë, në një bisedë telefonike,z. S.D. i tha ankuesit se mbetjet mortore të gruas së tij vërtet ishin larguar nga vendi i varrimit dhe ishin dërguar në Rahovec.

30. Ankuesi vazhdon duke thënë se ai vetë shkoi në Prizren në gusht të vitit 2005 dhe vizitoi varrezat. Një përfaqësues i administratës së varrezave ia tregoi ankuesit vendin ku ishin varrosur serbët. Vendi dukej të jetë gërmuar plotësisht dhe disa kryqe të thyera varrimi gjendeshin të grumbulluar në afërsi. Ankuesi ia ofroi Panelit fotografitë që ai i bëri me atë rast.

31. Ankuesi nuk qartësoi se cilave autoritete ai ua raportoi zhdukjen e mbetjeve mortore të gruas së tij. Një certifikatë e Kryqit të Kuq të Serbisë dhe Malit të Zi, e datës 13 qershor 2005, drejtuar në adresë të ankuesit, konfirmon se znj. Krasenka Alinoviq konsiderohet si e zhdukur nga 14 qershori i vitit 1999, dhe është e përfshirë në listën e personave të zhdukur në Kosovë.

32. Ai, po ashtu, informon Panelin se në mars të vitit 2003, KNPZH mblodhi mostrat e gjakut nga vajza dhe dy vëllezërit e znj. Krasenka Alinoviq, për identifikim të mundshëm përmes ADN-së.

33. Edicioni i 1^{rë}, 2^{të}, 3^{të}dhe 4^{të} i librit të KNKK-së *Personat e zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë*(të botuar në maj të vitit 2000, mars të vitit 2001, shkurt të vitit 2004 dhe qershor të vitit 2007) nuk e paraqesin në listë znj. Krasenka Alinoviq në mesin e personave të zhdukur. Megjithatë, burimi elektronik i KNKK-së *Lidhjet familjare* përmban një kërkesë të hapur për kërkim në lidhje me gruan e ankuesit; në të paraqitet 8 gushti i vitit 1999 si data e zhdukjes së saj[3].Nuk është e qartë se kur është paraqitur kjo kërkesë për kërkim.

[3]Shih: Baza e të dhënave e KNKK-së [burimi elektronik]-http://familylinks.icrc.org/kosovo/en/pages/search-persons.aspx (e qasur më 23 qershor 2015).

34. Në shënimin në lidhje me znj. Krasenka Alinoviq në bazën e të dhënave 'online' të mbajtur nga KNPZH[4] jepet 18 gushti i vitit 1999 si data zhdukjes së saj dhe tregohet se "Nuk janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë".

C. Dokumentet që i janë paraqitur Panelit

35. Në rastin aktual, Paneli pranoi nga UNMIK-u kopjet e dokumenteve që më parë i kishin mbajtur Policia e UNMIK-ut dhe ZPZHML. Kur ia paraqiti dosjen Panelit, më 29 qershor 2012, PSSP-ja informoi Panelin se dosjet ishin "rudimentare" dhe nuk "janë mjaft të dobishme për përgatitjen e ... komenteve". Megjithatë, më 20 prill 2015, UNMIK-u ia konfirmoi Panelit se nuk janë marrë më shumë dokumente relevante.

Dosja e ZPZHML-së

36. Kjo pjesë e dosjes përmban një formular, pa datë, për identifikim të viktimës për znj. Krasenka Alinoviq, i plotësuar me dorë (në gjuhën angleze). Përveç që përmban detajet e saj personale dhe përshkriminante-mortem, ai ofron emrat dhe detajet e plota për kontakt të vajzës së saj dhe ankuesit.Në rubrikën "arsyet për të supozuar se personi në fjalë është viktimë e fatkeqësisë" thuhet:

> [Znj.Krasenka Alinoviq] ishte hospitalizuar në Spitalin e Prizrenit nga 19 marsi i vitit 1999. Informatori thotë se ajo vdiq në spital më 8gusht 1999. Pas kësaj ajo është varrosur në varrezat e Prizrenit nga KFOR-i, UNMIK-u dhe pjesëtarët e KNKK-së.

37. Dosja përmban më tutje një formular për identifikim të viktimës të KNKK-së, i plotësuar me dorë (në gjuhën serbe), i ndërlidhur me lëndën nr. 2003-000010. Përveç regjistrimit të detajeve të saj personale dhe përshkrimit ante-mortem, ai ofron emrat dhe detajet e plota për kontakt të vajzës së saj, vëllait dhe ankuesit. Në rubrikën"Detaje të zhdukjes" në faqen e parë thuhet: "Vdiq në Spitalin e Prizrenit më 8 gusht 1999"; në rubrikën"Vendi i mundshëm i varrimit" thuhet (është ruajtur shprehja origjinale): "*Me sa duket është varrosur në varrezat e Prizrenit nga ndërmarrja "Hygijena"*." Në rubrikën "Rrethanat e zhdukjes" në faqen F2 thuhet "*Vdiq në Spitalin e Prizrenit; e varrosur në varrezat ortodokse, por vendi i saktë nuk dihet*". Të bashkëngjitura në këtë formular janë fotografia e saj, një dokument i shkruar me dorë që ofron detajet e personave të përfshirë në varrimin e saj dhe detajet e plota për kontakt të vajzës dhe vëllait të saj në Kroaci dhe Serbi.

38. Dosja, po ashtu, përmban kopjet e certifikatës së lindjes së znj. Krasenka Alinoviq dhe dy formularë, të datës 14 prill 1999, përmes të cilëve ajo raportoi vendqëndrimin e saj në Prizren.

39. Në dosje, po ashtu, është një kopje e një ekstrakti nga regjistri i vdekjeve në Komunën e Prizrenit, i datës 27 dhjetor 1999. Në të konfirmohet se vdekja e znj. KrasenkaAlinoviq, e cila kishte ndodhur më 8 gusht 1999, është regjistruar sipas shënimit nr. 67/53–1999. Kjo certifikatë pasohet nga kopjet e dokumenteve të njëjta në lidhje me vdekjen e saj, të lëshuara nga KNKK dhe Spitali i Prizrenit (shih §§ 28më lart).

40. Në fund të kësaj pjese të dosjes janë kopjet e shtatë fotografive që nuk shihen mirë, pa ndonjë shënim sqarues.

Dosja e Policisë së UNMIK-ut

[4]Baza e të dhënave e KNPZH-së [burimi elektronik]-www.ic-mp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en (e qasur më 23 qershor 2015).

Lënda 2002-000661

41. Kjo pjesë e dosjes përmban pesë dokumente nga lënda për hetimin e NJPZH-së nr. 2002-000661, të ndërlidhura me atë të KNKK nr. BLG-804538-01. Kanë të bëjnë me zhdukjen e B.S., më 16 qershor 1999 në Prizren. Dy nga këto dokumente janë formularë të veçantë, pa datë, të historikut të rastit të shtypur nga baza e të dhënave e NJPZH-së. Të dytë përmbajnë shënimin vijues:

> Sipas informatave të KNKK-së S.B., Krasenka Alinoviq dhe C.M. duhet të varrosen në varrezat ortodokse të Prizrenit. Ne bëmë zhvarrim në varrezë në vitin 2002 sipas kodit të vendit FQA...

Lënda 2003-000010

42. Dosja përmban një raport për vazhdim të rastit të NJPZH-së, i bashkëngjitur në lëndën nr. 2003-000010, në lidhje me trupin e znj. KrasenkaAlinoviq, me një shënim të vetëm, të datës 6 shkurt 2003, në të cilin thuhet:

> Input DB & DVI OK.
> Të bashkëngjitura janë:
> 1. Fotografitë e varrezës (Varre. Ort. Priz.)
> 2. Certifikata e vdekjes
> 3. Shënimet e mjekut (raporti mjekësor me diagnozë dhe shkaktarin e vdekjes).

Konfirmimi i DML-së

43. Me kërkesën e Panelit, më 20 prill 2015, DML sqaroi se në vitin 2002 ishte bërë vërtet një zhvarrim në varrezat e Prizrenit (lokacioni me një kod të vendit“FQA”) dhe se akoma janë katër trupa të paidentifikuar femrash nga ai zhvarrim në morgun e DML-së.

44. DML sqaroi se përshkrimi fizik i këtyre katër trupave dallon dukshëm nga ai i znj. KrasenkaAlinoviq (p.sh. ajo ishte shumë më e gjatë). Veç kësaj, autopsitë kishin vërtetuar se dy nga ato femra të paidentifikuara kishin vdekur nga plagët nga armët e zjarrit ndërsa dy të tjerat kishin vdekur nga “trauma [t] e shkaktuar me përdorimin e një mjeti të pamprehur”. Pasi znj.Krasenka Alinoviq kishte vdekur nga shkaqet natyrore, DML pohon se asnjëra nga ato mbetje mortore nuk mund të jenë të saj.

45. Më 28 prill 2015, DML konfirmoi më tutje se, në kundërshtim me informatat e lartpërmendura nga faqja e internetit e KNPZH-së (shih § 33), kishte mostra të mjaftueshme për të mundësuar identifikim të mbetjeve mortore të znj. KrasenkaAlinoviq përmes ADN-së.Megjithatë, nuk është gjetur përshtatje e ADN-së. Prandaj, DML është i mendimit se mbetjet e saj mortore nuk ishin zhvarrosur nga varrezat e Prizrenit në vitin 2002.

Konfirmimi i KNKK-së

46. Më 18 maj 2015, me kërkesën e Panelit, Zyra e KNKK-së në Prishtinë ia konfirmoi Panelit se znj. Krasenka Alinoviq i është raportuar si e zhdukur KNKK-së nga familja e saj, dhe KNKK e kishte hapur një rast me nr. reference BLG-804796-01 në lidhje me të. Deri më tani, KNKK-ja nuk ka ndonjë informatë të re për vendndodhjen e mbetjeve të saj mortore, prandaj rasti mbetet i hapur në regjistrate KNKK-së.

47. KNKK-ja theksoi më tutje se emri i saj gjendet për herë të parë në edicionin e 5-tëtë librit të KNKK-së*Personat e zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë*,i publikuar në prill të vitit 2013.KNKK-ja, po ashtu, sqaroi se praktika e tyre është t'i konsiderojë si situata të rasteve për persona të zhdukur, ku një person është parë si i vdekur (pavarësisht nga shkaktarët e vdekjes),por vendndodhja e mbetjeve mortore (vendi i varrimit) është e panjohur për familjen.

48. KNKK-ja nuk u përgjigj në pyetjen e Panelit për sa i përket asaj se, kur kërkesa për kërkimin e znj. Krasenka Alinoviq ishte hapur dhe kur KNKK-ja informoi UNMIK-un (nëse kishte informuar fare) se ajo konsiderohej si një "person i zhdukur".

III. ANKESA

49. Ankuesi ankohet rreth dështimit të UNMIK-ut që të informojë si duhet atë rreth vdekjes së gruas së tij dhe rreth zhvendosjes së mbetjeve të saj mortore, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe vuajtje.

50. Paneli konsideron se ankuesi thirret në shkeljen e së drejtës së tij për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues, e garantuar me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe së drejtës së tij për respektim të jetës private dhe jetës familjare, e garantuar me nenin 8 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

51. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.

52. Paneli thekson që me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligimet sipas këtyre instrumenteve për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet me të, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

53. Paneli, po ashtu, thekson që neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/12, i 23 marsit 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli "shqyrton ankesat nga çdo person apo grup individësh që pohojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave (të tyre) të njeriut nga UNMIK-u". Pra vetëm aktet apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut bien brenda juridiksionit *rationepersonae* të Panelit. Në lidhje me këtë, duhet përmendur, siç është theksuar më lart, që prej 9 dhjetorit 2008 UNMIK-u nuk ushtron më autoritetin ekzekutiv mbi gjyqësinë e Kosovës dhe aparatin për zbatimin e ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk bart asnjë përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet se janë kryer nga ato autoritete. Sa i përket ankuesve që ankohen rreth akteve që kanë ndodhur pas asaj date, ato janë jashtë juridiksionit *rationepersonae* të Panelit.

54. Po ashtu, Paneli thekson që, sa i përket juridiksionit të vet *rationemateriae*, siç vijon nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Kjo nënkupton që mundet vetëm t'i shqyrtojë aktet apo lëshimet për të cilat është bërë ankesë rreth pajtueshmërisë së tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura më lart (shih § 52).

55. Paneli thekson më tutje se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që Paneli ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut "që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Pra, ngjarjet që kanë ndodhur para 23 prillit 2005, përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *rationetemporis* të Panelit. Megjithatë, në rastin kur ngjarjet e tilla kanë shkaktuar një situatë të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion t'i shqyrtojë ankesat që ndërlidhen me atë situatë (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Dhoma e Lartë [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 18 shtator 2009, §§ 147-149; GJEDNJ, *Qiproja kundër Turqisë* [DHL], numër 25781/94, vendimi i gjykatës, 10 maj 2011, § 136, KEDNJ 2001-IV).

B. Shkelja e pretenduar e nenit 3 të KEDNJ-së

1. Parashtresat e palëve

56. Ankuesi në esencë ankohet për shkelje që kanë të bëjnë me dështimin e UNMIK-ut që të informojë si duhet atë rreth vdekjes së gruas së tij dhe rreth zhvendosjessë mbetjeve të saj mortore, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe vuajtje.

57. PSSP-ja nuk ofroi asnjë koment për bazueshmërinë e ankesës. Megjithatë, ai pajtohet për pranueshmërinë e pjesëve të ankesës në lidhje me largimin e supozuar dhe më pas humbjen e mbetjeve mortore të gruas së ankuesit,por vetëm nga momenti kur rasti iu raportua UNMIK-ut, dhe deri në fund të juridiksionit të përkohshëm të Panelit, i cili në këtë rast do të ishte 9 dhjetori i vitit 2008.Sipas mendimit të tij, pjesa tjetër e ankesës duhet shpallur e papranueshme *ratione personae.*

2. Vlerësimi i Panelit

58. Ankuesi në esencë pohon që mungesa e gjatë e informatave lidhur me vendndodhjen e mbetjeve mortore të gruas së tij paraqet trajtim jonjerëzor dhe degradues në kuadër të kuptimit të nenit 3.

a) Parimet e përgjithshme

59. Neni 3 i KEDNJ-së ruan një nga vlerat më fundamentale në shoqëritë demokratike (GJEDNJ, *Talat Tepe kundër Turqisë,* nr. 31247/96, 21 dhjetor 2004, § 47; GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë,* nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 424). Siç konfirmohet nga natyra absolute e dhënë për të me nenin 15 § 2 të KEDNJ-së, ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor dhe degradues vlen, madje në rrethanat më të vështira.

60. Paneli rikujton se esenca e ankesës para tij sipas nenit 3 të KEDNJ-së nuk është se ka pasur shkelje serioze të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me të ndjerën znj.KrasenkaAlinoviq, por më parë ka të bëjë me dhimbjen dhe vuajtjen e burrit të saj për shkak të asaj se nuk ishte në gjendje të zbulojë se ku ishte varrosur gruaja e tij.

61. Për sa i përket rasteve të tilla, Gjykata Evropiane thekson që "me qëllim që të konstatohet shkelje e nenit 3 të Konventës për sa i përket të afërmve të viktimës, duhet të ekzistojnë faktorë të veçantë, të cilët i japin vuajtjes së tyre një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional që vlerësohet se pashmangshëm shkaktohet nga vetë shkelja e lartpërmendur. Faktorët relevantë do të përfshijnë afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, shkalla deri në të cilën anëtari i familjes dëshmoi ngjarjet në fjalë, përfshirjen e parashtruesve në përpjekjet për të marrë informata mbifatin e të afërmve të tyre" (GJEDNJ [DHL], *Janowiecdhe të tjerët kundër Rusisë*,nr. 55508/07 dhe 29520/09, vendimi i 21 tetorit të vitit 2013, § 177).

62. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se "një anëtar i familjes së një 'personi të zhdukur' mund të pohojë të jetë viktimë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në rastet ku zhdukja është pasuar nga një periudhë e gjatë e pasigurisë derisa është gjetur trupi i personit të zhdukur. Esenca e çështjes sipas nenit 3 në rastin e këtij lloji nuk qëndron aq shumë në shkelje serioze të të drejtave njerëzore të personit të zhdukur por më parë në reagimet dhe qëndrimet shpërfillëse të autoriteteve në atë situatë kur çështja është sjellë në vëmendjen e tyre" (*ibid*., § 178).

63. Paneli rikujton se autoritetet e kanë për detyrë t'i përmbushin kërkesat e nenit 3,pavarësisht nga ajo nëse ishin përgjegjëse për aktin ekzistues të vdekjes apo zhdukjes (shih*Açışkundër Turqisë*, nr. 7050/05, §§ 36, 51-54, 1 shkurt 2011, në të cilin rast burri dhe babai i parashtruesve ishin rrëmbyer nga lëvizja separatiste).Sipas mendimit të Gjykatës Evropiane, pavarësisht asaj "[a]jo detyrë mund të rezultojë edhe nga dështimi i autoriteteve për t'iu përgjigjur pyetjeve për informata nga të afërmit apo pengesat e vendosura në rrugën e tyre, duke i lënë ata të mbajnë peshën kryesore të përpjekjeve për të zbuluar ndonjërin nga faktet, e ku ky qëndrim mund të vlerësohet si një shprehje e një shpërfilljeje flagrante, të vazhdueshme dhe epashpirt e një obligimi për të shpjeguar fatin e personit të zhdukur" (ibid., § 178; shih po ashtu, në mes shumë tjerash, GJEDNJ, *Açışkundër Turqisë*, nr. 7050/05, vendimi i 1 shkurtit të vitit 2011, §§ 36 dhe 51-54;GJEDNJ *Varnavadhe të tjerët*, përmendur në § 55më lart, në §200;GJEDNJ, *Luluyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr.69480/01, vendimi i 9 nëntorit të vitit 2006, § 114;GJEDNJ,*Gongadze kundër Ukrainës*, nr.34056/02, vendimi i 8 nëntorit të vitit 2005, § 184).Gjykata, po ashtu, e ka marrë parasysh të konstatuarit e një shkelje të veçantë të nenit 3,e cila shpjegohet të jetë në situatat e vdekjes së konfirmuar ku parashtruesit ishin dëshmitarë të drejtpërdrejtë të vuajtjes së anëtarëve të tyre të familjes (shih GJEDNJ [DHL], *Janowiec dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në § 61më lart, në § 181, dhe rastet e përmendura aty).

64. Paneli konsideron se, megjithëse znj. Krasenka Alinoviq nuk ishte viktimë e shkeljes së ndonjë të drejte të njeriut, situatënlidhur me trupin e saj të zhdukur duhet trajtuar si e krahasueshme me atë të një personi të zhdukur, me qëllim të përcaktimit nëse ndaj të afërmittë saj të afërt – burrit të saj – është bërë shkelje e së drejtës së tij të mbrojtur sipas nenit 3 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton praktikën e KNKK-së t'i kualifikojë si raste të situatave të personave të zhdukur ku nuk ka asnjë dyshim për vdekjen e një personi, por vendndodhja e mbetjeve të tij apo saj mortore është e panjohur (shih § 47më lart).

65. Paneli thekson që obligimi sipas nenit 3 të KEDNJ-së dallon nga obligimi procedural mbi autoritetet sipas nenit 2. Ndërsa i fundit kërkon nga autoritetet të ndërmarrin veprim specifik ligjor që është në gjendje të çojë kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës, i pari është më i përgjithshëm dhe humanitar sipas natyrës pasi ai udhëzon autoritetet të reagojnënë një mënyrë humane ndaj gjendjes së vështirë të të afërmve të individit që ka

vdekur apo është zhdukur dhe të tregojnë dhembshuri" (shih GJEDNJ [DHL], *Janowiecdhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur më lart, në § 152).

66. Paneli gjithashtu e merr parasysh që sipas Gjykatës Evropiane, analiza e reagimit të autoriteteve nuk duhet të kufizohet në ndonjë manifestim specifik të qëndrimeve të autoriteteve, incidente të izoluara apo akte procedurale. Përkundrazi, sipas mendimit të gjykatës, vlerësimi i mënyrës me të cilën autoritetet e shtetit të paditur iu përgjigjen pyetjeve të parashtruesve duhet të jetë i përgjithshëm dhe i vazhdueshëm " (shih GJEDNJ, *Açiş kundër Turqisë,* përmendur në §63 më lart, në § 45).

b) Aplikimi i atyre parimeve në rastin aktual

Shqyrtime preliminare

67. Paneli thekson afërsinë e lidhjeve familjare ndërmjet ankuesit dhe znj. Krasenka Alinoviq, pasi kjo e fundit është gruaja e ankuesit.

68. Paneli thekson se faktet vijuese duket se nuk kontestohen nga palët: qëznj.Alinoviq kishte vdekur vërtet nga shkaqe natyrore në Spitalin e Prizrenit më 8 gusht 1999; që trupi i saj ishte varrosur më vonë në varrezat e qytetit të Prizrenit;që vendi i saktë i varrit të saj në atë varrezë nuk është i njohur; dhe që pas vitit 1999 ishte kryer në atë varrezë së paku një zhvarrim i një numri të mbetjeve mortore, të dyshuara të jenë ato të banorëve të paidentifikuar lokalë serbë, të cilët ishin vrarë menjëherë pas arritjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut në Prizren dhe në zonën e afërt.

Mungesa e supozuar e informatave në lidhje me vdekjen e znj. Krasenka Alinoviq

69. Paneli thekson deklaratën e ankuesit se më 14 gusht 1999,ai u vu në dijeni për vdekjen e gruas së tij, nga një pjesëtar i stafit të KNKK-së. Pjesëtari i njëjtë i stafit të KNKK-së, po ashtu, i ofroi atij një kopje të certifikatës mjekësore të vdekjes, të lëshuar nga Spitali i Prizrenit, dhe një fotografi të varrit të znj. Alinoviq në varrezat e Prizrenit; ankuesi ia ofroi një kopje të asaj certifikate Panelit (shih § 27më lart)

70. Përveç kësaj, menjëherë më pas, vajza e znj.Krasenka Alinoviq pranoi një certifikatë të KNKK-së, që po ashtu konfirmonte vdekjen e znj. Alinoviq; një kopje e kësaj certifikate, po ashtu, i është vënë në dispozicion Panelit (shih § 28më lart).

71. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në terren në Kosovë në vitin 1999, Paneli është i kënaqur se ankuesi dhe familja e tij ishin të njoftuar si duhet rreth vdekjes së znj. Krasenka Alinoviq dhe se atyre u janë ofruar dokumentet relevante.

72. Prandaj, duke pasur parasysh dëshminë para tij, Paneli nuk është në gjendje të konstatojë shkelje të nenit 3 në këtë pjesë të ankesës.

Zhvarrimi i supozuar i mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq

73. Siç pohon ankuesi më tutje, mbetjet mortore të gruas së tij ishin zhvarrosur më vonë, pa dijeninë dhe pëlqimine tij, me sa duket nga UNMIK-u apo KFOR-i; sipas ankuesit, vendndodhjet e tyre mbesin të panjohura.

74. Në përkrahje të pohimit të tij, ankuesi, po ashtu, thekson se z. S.D., një mjek i mjekësisë ligjore që punonte për Qeverinë serbe, i tha atij se, ai ishte i pranishëm gjatë zhvarrimit të

kryer nga ZPZHML-ja dhe konfirmoi se mbetjet mortore të znj.KrasenkaAlinoviqvërtet ishin larguar nga vendi i varrimit dhe ishin çuar në institucionin e mjekësisë ligjore në Rahovec (shih § 29më lart). Ankuesi vizitoi varrezat e Prizrenit në vitin 2005, ku atij iu tregua vendi ku trupi i gruas së tij thuhet të jetë varrosur; vendi dukej se ishte gërmuar plotësisht (shih § 30më lart).

75. Ankuesi ia paraqiti Panelit një koleksion me fotografi që ai i kishte bërë me atë rast. Megjithëse ato fotografi tregojnë një pjesë të varrezave të Prizrenit me një numër varresh të posahapura, nuk është e qartë se cilatpjesë të varrezës paraqiten apo nëse ato tregojnë gjetjen aktuale të varrit të znj. Krasenka Alinoviq.

76. Iu konfirmua Panelit nga DML se në vitin 2002 ZPZHML vërtet kishte gërmuar varre të caktuara në varrezën e Prizrenit (kodi për vendin "FQA"),me qëllim të zhvarrimit të mbetjeve mortore të personave të paidentifikuar, kryesisht serbë, të varrosur atje pas konfliktit (shih § 43më lart). DML, po ashtu, konfirmoi se ata kanë mostra të mjaftueshme të ADN-së për të mundësuar identifikim pozitiv të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq, por deri më tani asnjë përshtatje nuk është gjetur. Prandaj, sipas DML-së, mbetjet mortore të znj. Alinoviq me sa duket nuk ishin zhvarrosur dhe kështu ka të ngjarë të jenë akoma në varrezën e Prizrenit (shih § 45më lart).

77. Duke rikujtuar se vendi i saktë i varrit të znj. Krasenka Alinoviq në varrezat e Prizrenit nuk është i njohur, Paneli konsideron se ka dyshim nëse mbetjet e saj mortore ishin zhvarrosur apo jo nga vendi i parë i varrimit. Paneli nuk është në gjendje të dallojë qartë nga dëshmia e paraqitur nga ankuesi dhe informatat nga DML-ja nëse mbetjet e saj mortore vërtet ishin larguar apo jo.

78. Prandaj, duke pasur parasysh dëshminë para tij, Paneli përsëri nuk është në gjendje të konstatojë shkelje të nenit 3 në këtë pjesë të ankesës.

Dështimi i pretenduar i UNMIK-ut që të veprojë në lidhje me humbjen e mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq

79. Paneli konsideron se ai nuk mund ta përjashtojë plotësisht mundësinë se mbetjet mortore të znj. Krasenka Alinoviq vërtet ishin zhvarrosur pa dijeninë dhe pëlqimine familjes së saj dhe më pas ishin zhvendosur nga autoritetet e UNMIK-ut. Megjithatë, siç është përmendur më lart, është po ashtu e mundshme që mbetjet e saj mortore të jenë akoma në vendin e parë të varrimit, por problemi qëndron në gjetjen e varrit.

80. Paneli rikujton në këtë drejtim që KNKK dhe KNPZH akoma e konsiderojnë znj. Krasenka Alinoviq si një person të zhdukur (shih §§ 33 - 34më lart).

81. Megjithëse nuk ka asnjë dyshim se znj. Krasenka Alinoviq kishte vdekur nga shkaqet natyrore, akoma mund të ketë një obligim nga ana e autoriteteve për të hetuar çështjen, ngjashëm me atë për zhdukjet sipas nenit 2 të KEDNJ-së (e drejta në jetë, pjesa procedurale). Megjithatë, përgjegjësia e tillë do të ekzistonte sapo çështja të arrinte në vëmendjen e tyre (shih, p.sh., GJEDNJ [DHL], *Shilih kundër Sllovenisë*, nr. 71463/01, § 157;GJEDNJ, *Gongadze kundër Ukrainës*, përmendur në § 63më lart, §185).

82. Paneli ka gjetur në një numër rastesh se autoritetet e UNMIK-ut ishin të obliguara t'i hetojnë zhdukjet nga koha që ato ishin vënë në dijeni për pretendimet e tilla (shihp.sh.*Bullatoviq*, nr. 165/09, vendimi i 21 dhjetorit të vitit 2011, §§ 16 - 17; *Baraq*, nr. 149/09, vendimi i 1 tetorit të vitit 2012, §§ 15 - 16). Paneli, po ashtu, i ka marrë parasysh njoftimet për zhdukjet të

KNKK-së për UNMIK-un të jenë të mjaftueshme për të krijuar obligim për të hetuar sipas nenit 2 (shih, në mes tjerash, *Mitiq dhe të tjerët*, nr. 63/09 dhe të tjerët, mendimi i 14 marsit të vitit 2014, §§ 45 dhe 156).

83. Në lidhje me këtë, Paneli e pranon se dosja para tij përfshinë një dokument që konfirmon se kishte një rast të hapur nga NJPZH-ja,me sa duket në vitin 2003, në lidhje me znj. Krasenka Alinoviq, (shih § 42më lart). Paneli thekson se dosja e NJPZH-së përmban certifikatën e vdekjes që konfirmon se ajo vdiq nga shkaqet natyrore dhe prandaj tregonte se nuk ishte shkaktuar nga një akt kriminal.

84. Kështu, Panelit i duket se NJPZH, bazuar në informatat në dispozicion të tyre, e kishte kualifikuar fillimisht rastin e znj. Krasenka Alinoviq si vrasje e mundshme dhe/apo zhdukje (shih § 42 më lart).Megjithatë, me konfirmimin se ajo në fakt vdiq nga shkaqe natyrore dhe më pas ishte varrosur në varrezat e Prizrenit, dhe për shkak të mandatit të vet specifik (shih§ 24më lart), NJPZH mund të ndërpriste hetimin e vet pasi nuk kishte asnjë dyshim për sa i përket fatit të saj.

85. Veç kësaj, Paneli konsideron se, pasi nuk kishte asnjë çështje sipas nenit 2 në këtë rast, autoritetet relevante të UNMIK-ut nuk duhej të "vepronin duke bërë vetë lëvizje sapo që çështja të arrinte në vëmendjen e tyre"; ato do të mund të prisnin në mënyrë legjitimeqë "i afërmi të paraqiste një kërkesë zyrtare apo të marrë përgjegjësinë për kryerjen e ndonjë procedure hetimore" në këtë drejtim (shih, *a contrario*, GJEDNJ [DHL], *Ílhan kundër Turqisë*, nr. 22277/93, vendimi i 27 qershorit të vitit 2000, § 63, KEDNJ 2000-VII; GJEDNJ, *Rantsev kundër Qipros* dhe Rusisë, nr. 25965/04, vendimi i 7 janarit të vitit 2010, § 232; GJEDNJ[DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55721/07, vendimi i 7 korrikut të vitit 2011, § 165).

86. Megjithatë, ankuesi nuk ka pohuar se ai ka kontaktuar ndonjë autoritet të UNMIK-ut për t'i informuar ata për situatën dhe t'u kërkojë atyre që të japin sqarim rreth gjetjes së mbetjeve mortore të gruas së tij; ai i referohet vetëm një kontakti me z. S.D., një zyrtar i Qeverisë serbe që merrej me personat e zhdukur (shih § 29 më lart). Paneli rithekson se dosja nuk përmban asnjë indikacion se në rastin aktual autoritetet e UNMIK-ut u informuan ndonjëherë apo ishin vënë në dijeni për zhdukjen e supozuar të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq dhe që iu kërkua t'i gjejnë ato.

87. Paneli shpreh keqardhje që ankuesi deri më tani nuk ka qenë gjendje ta gjejë vendin ku pushon përfundimisht gruaja e tij, e cila padyshim i shkaktoi atij dhimbje dhe vuajtje.Megjithatë, në rrethanat e përshkruara Paneli nuk është bindur se me sjelljen e tyre autoritetet e UNMIK-ut i shkaktuan apo në çfarëdo mënyre i kontribuuan shqetësimit mental të parashtruesit në lidhje me vdekjen dhe më pas zhdukjen e supozuar të mbetjeve mortore të znj. Krasenka Alinoviq.

88. Prandaj, në këtë rast Paneli nuk konstaton shkelje të nenit 3 nga UNMIK-u.

C. Shkelja e pretenduar e nenit 8 të KEDNJ-së

1. Parashtresat e palëve

89. Ankuesi në esencë ankohet për shkelje që kanë të bëjnë me dështimin e UNMIK-ut që të informojë si duhet atë rreth vdekjes së gruas së tij dhe rreth zhvendosjes së mbetjeve të saj mortore, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe vuajtje.

90. Komentet e PSSP-së në lidhje me ankesën sipas nenit 3 vlejnë njësojnë lidhje me ankesën sipas nenit 8 (shih§57 më lart).

2. Vlerësimi i Panelit

a) Parimet e përgjithshme

91. Paneli i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila thotë në lidhje me konceptin e "jetës familjare" se qëllimi thelbësori nenit 8 është që të mbrojë individin nga veprimi arbitrar i autoriteteve publike. Mund të ketë, përveç kësaj, obligime pozitiveekzistuese që nuk japin efektpër "respektim" të jetës familjare. Megjithatë, nuk ka asnjë përkufizim të qartë të kufijve në mes obligimeve ekzistuese pozitive dhe negative sipas këtij neni, ku "balanca e drejtë … duhet gjetur në mes interesave garuese të individit dhe shoqërisë në tërësi; dhe në të dy kontekstet shteti gëzon një hapësirë të caktuar për vlerësim" (shih, p.sh., GJEDNJ, *Kroon dhe të tjerët kundër Holandës*, nr. 18535/91, vendimi i 27 tetorit të vitit 1994, § 31; GJEDNJ, *Znamenskaya kundër Rusisë*, nr. 77785/01, vendimi i 2 qershorit të vitit 2005, § 28).

92. Gjykata e ka përcaktuar se e drejta për të varrosur të afërmit (pa bërë dallim në mes trupit të plotë dhe pjesëve të tij) mbrohet me nenin 8 dhe interferenca me të mund të përbëjëshkelje të të drejtave të parashtruesit për jetë private dhe familjare (shihGJEDNJ, *Girard kundër Francës*, nr. 22590/04, vendimi i 30 qershorit të vitit 2011, § 101).

93. Gjykata, po ashtu, i ka konsideruar shkeljet e të drejtave të mbrojtura me nenin 8 në situatat vijuese: vonesa e tepërt në kthimin e një trupi pas një autopsie, apo mostrave të indeve të marra nga trupi, pas përfundimittë procedurave relevante penale (shih *Pannullo dhe Forte kundër Francës*, nr. 37794/97, vendimi i 30 tetorit të vitit 2001, §§ 35-36; *Girard kundër Francës*, përmendur më lart, § 107); refuzimi për të transferuar një urnëqëpërmbanhirin e gruas së ankuesit(shih *Elli Poluhas Dödsbo kundër Suedisë*, nr. 61564/00, vendimi i 17 janarit të vitit 2006, §§ 19-29); refuzimi për të dorëzuar trupin e burrit të ankueses të vrarë gjatë një operacioni antiterrorist (shih *Maskhadova dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 18071/05, vendimi i 6 qershorit të vitit 2013, §§ 225 - 238).

94. Përveç kësaj, në praktikën gjyqësore konsiderohet se autoritetet duhet të vihen në dijeni për një situatë të një shkelje të supozuar të të drejtave të mbrojtura me nenin 8dhe procesi përkatës ligjor dhe administrativ duhet të ndodhë para se të paraqitet një ankesë sipas këtij neni.Megjithëse mund të ekzistojnë obligime pozitive për autoritetet, ato nuk janë të obliguara të veprojnë me iniciativën e tyre, në mungesë të një kërkese formale nga pala të drejtat e së cilës pretendohet të jenë prekur sipas kësaj dispozite (shih p.sh.. GJEDNJ, *Pannullo dhe Forte kundër Francës*, përmendur më lart; GJEDNJ,*Znamenskaya kundër Rusisë*, përmendur më lart;GJEDNJ,*Zorica Jovanoviq kundër Serbisë*, nr. 21794/08, vendimi i 26 marsit të vitit 2013).

b) Aplikueshmëria e atyre parimeve në rastin aktual

95. Paneli thekson se ekzistenca e lidhjeve familjare në mes ankuesit dhe znj. Alinoviq nuk kontestohet nga palët. Faktet e tjera relevante që nuk kontestohen janë paraqitur më lart (shih § 68).

96. Megjithatë, siç është përmendur tashmë më lart, Paneli nuk ka gjetur dëshmi të mjaftueshme për të provuar, *e para*, se mbetjet mortore të gruas së ankuesit vërtet ishin larguar nga varri, dhe*e dyta*, se ankuesi ishte ankuar tek autoritetet relevante të UNMIK-ut rreth asaj, apo se ai

kishte kërkuar, pa sukses, nga UNMIK-u që të gjejë vendndodhjen e mbetjeve të saj mortore. Prandaj, duke pasur parasysh dëshminë para tij, Paneli nuk është në gjendje të konstatojë shkelje të nenit 8.

97. Paneli përsërit keqardhjen e vet se deri në ditën e sotme ankuesi nuk ka qenë në gjendje të gjejë vendin e fundit ku pushojnë mbetjet mortore të gruas së tij, e cila padyshim i shkakton atij dhimbje dhe vuajtje. Megjithatë, Paneli nuk gjen dëshmi të mjaftueshme se autoritetet e UNMIK-ut në ndonjë mënyrë interferuan në të drejtën e ankuesit për jetë familjare. Prandaj, Paneli përfundon se nuk kishte asnjë shkelje të të drejtave të ankuesit nga UNMIK-u të mbrojtura me nenin 8 të KEDNJ-së.

98. Në lidhje me këtë, Paneli këshillon që UNMIK-u duhet të ndërlidhet me autoritetet relevante në Kosovë me qëllim që të ndihmohet ankuesi, z. Petar Joviçiq, për gjetjen e mbetjeve mortore të gruas së tij.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 3 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

2. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.**

Andrey Antonov	Marek Nowicki
Zyrtar ekzekutiv	Kryesues

Shtojca

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

CCPR - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
DFM - Departamenti i Mjekësisë Ligjore
ECHR – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EU – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
FRY – Republika Federale e Jugosllavisë
HRAP – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
ICMP – Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
ICRC – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
MPU – Njësiti për Persona të Zhdukur
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OMPF – Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore
SRSG – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
WCIU – Njësiti për Hetim të Krimeve të Luftës